



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023

Nr: 524

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**PAJISJEN E QENDRËS SË POSAÇME TË VOTIMIT NR. 0748/01, KZAZ NR. 13, BASHKIA LEZHË,
ME SASINË SHITESË TË FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve nr. 13, Bashkia Lezhë, ndërmjet komunikimit zyrtar kërkon fletë votimit shtesë për I.E.V.N Shënkoll, dhe i ka propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pajisjen e kësaj I.E.V.P me sasinë shtesë të fletëve të votimit për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur të cilët kanë të drejtë vote por nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve të kësaj qendre të posaçme votimi.

Shtetasit të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion kanë fituar të drejtën për të votuar në qendrën e posaçme të votimit nr. 0748/01, KZAZ nr. 13, Bashkia Lezhë, sipas vendimit të gjykatës.

Në këto kushte, KQZ duhet të marrë masa të sigurojë sasi shtesë të fletëve të votimi për të mundësuar votimin e shtetasve të sipërcituar.

Data: 14.5.2023 Nr: 524
Ora: 11:00



“Për pajisjen e qendrës së posaçme të votimit nr. 0748/01 KZAZ nr. 13, Bashkia Lezhë, me sasinë shtesë të fletëve të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 13, Bashkia Lezhë, që të pajisë me sasinë shtesë të fletëve të votimit, qendrën e posaçme të votimit nr. 0748/01.
2. Sasia shtesë e fletëve të votimit do të merren nga qendrat e votimit nr. 0760/00 dhe nr. 0761/00, të KZAZ nr. 13, respektivisht, nga 20 (njëzet) fletë votimi për kandidatët për kryetar bashkie dhe 20 (njëzet) fletë votimi për këshillin e bashkisë, nga secila qendër votimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI